

Data 23.02.2024

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

“SORRA” SH.P.K.

- Z.Ledio Sorra, i datëlindjes 20.05.1993, i lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikua ranga pasaporta me nr. **J30520087J**, me nr.telefoni 068 26 46 888.

Të cilët mbështetur në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, “Për shoqëritë Tregtare” dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithesi, kanë vendosur si më poshtë:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi tëkuifizuar, për të zhvilluar veprimtari private.

Shoqëria është person juridik Shqiptar, Veprimatria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni2

Shoqëria do të emërohet **“SORRA” SH.P.K**

Neni 3

Selia e Shoqërisë **“SORRA” SH.P.K** do të jetë në Rruga Gjokaj, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale 2726, me nr.pasurie 15.

Neni 4

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim asamblesë së ortakëve.

Shoqëria **“SORRA” SH.P.K** gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga moment i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.

Neni 5

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **“SORRA” SH.P.K** do të jetë:
Transport materiale inertesh , shitje dhe blerje inerte,material ndertimi.

Neni 6

Shoqëria ushton aktivitetin e saj mbi bazë dege në qytete të tjera të vendit, të cilat do të hapen pasi të ketë filluar aktiviteti i shoqërisë.

Neni 7

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 8

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të ritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë që merret në Bankat e Shtetit Shqiptarë. Kapitali Themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën **3 000 000 Lekë**, që i takon ortakëve themelues.

Ortakët pas zbritjes së taksave do t'i ndahen si vijon:

- Fondi Rezervë
- Shpërblimi që i takon ortakëve themelues në masën 100%.

Neni 9

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.

Neni 10

Veprimtaria e Shqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filial ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me Ligjin Shqiptar ose të huaj.

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve Ortakët gjëzojnë këto të drejta kryesore

Neni 11

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Pjesemarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasie të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk I liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më pare ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqesuesit të tij ose vetë.

- Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- Ti japi shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të Kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

Administrimi Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Neni 12

ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në Shoqërinë **“SORRA” SH.P.K**. Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. **Ledio Sorra** e cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e tij. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të shoqërisë **“SORRA” SH.P.K**

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interest të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Mbyllja e Shoqërisë:

Neni 13

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortakët, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentable si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijuar të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likujdimi.

Kur shoqëria likuidohet:

Neni 14

Asambleja e ortakutëve emëron likujdatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të këtij bilanci të likujdimit. Komisioni I Likujdimit përbëhet nganjë ose tre anetarë. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet finaciare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondeve finaciare ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 15

Kur pushon Veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Përgjithsme e ortakut.

Likujdimi i filialeve bëhet njësoj si për shoqërinë. Mjetet finaciare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi tu jenë bërë pagesat likujditorëve.

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z.LEDIO SORRA

Jedio Sorra

Sorra